



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Raporti vjetor Godišnji izveštaj Annual Report 2014



Prishtinë, 2015



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR
GODIŠNJI IZVEŠTAJ
ANNUAL REPORT
2014

Prishtinë, 2015

RAPORTI VJETOR 2014

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Vizioni dhe misioni	5
Fjala hyrëse e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Prof. dr. Enver Hasani.....	6
Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm, Milot Vokshi.....	7
Raporti vjetor i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2014.....	8
Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese	10
I. Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ).....	13
II. Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP).....	21
III. Departamenti i Regjistrimit të Lëndëve, Statistikës dhe Arkivit (DRLSA)	28
IV. Departamenti i Buxhetit dhe Financave (DBF).....	33
V. Njësia e Prokurimit (NJP)	39
VI. Njësia e Teknologjisë së Informacionit dhe Multimedieve (NJTIKM)	43
VII. Auditimi (NJA)	47
VIII. Njësia Ligjore (NJL).....	51
IX. Aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese	55
SHTOJCA I.....	64

Vizioni dhe misioni

1. Vizioni

Republika e Kosovës është shtet demokratik, i bazuar në sundimin e ligjit dhe në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit njerëzor, të garantuara me Kushtetutë. Në Kosovë, ku qytetarët vendosin nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, të cilët janë përgjegjës para tyre, Gjykata Kushtetuese do të jetë një institucion të cilin qytetarët e Kosovës e shohin si autoritet përfundimtar dhe garantues të Kushtetutës dhe të respektimit të ligjit.

E drejtuar nga Kushtetuta, Gjykata do t'i kontribuojë: (1) ndërtimit të një shteti të lirë, demokratik dhe paqedashës; (2) garantimit të të drejtave të secilit qytetar, lirive qytetare dhe barazisë së të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve para ligjit; dhe (3) eliminimit të gjurmëve të së kaluarës, duke krijuar tradita të reja juridike, të bazuara në sundimin e ligjit, në demokraci dhe në të drejta të njeriut.

2. Misioni

Si institucion i ri në demokraci të re, Gjykata Kushtetuese ka një rol të rëndësishëm në përmbushjen e vizionit të lartpërmendur. Megjithatë, Gjykata do të ballafaqohet me sfida të konsiderueshme ndaj përmbushjes së këtij roli, sepse ndryshimet e brendshme nuk janë të mjaftueshme. Gjykata, po ashtu, duhet të inkurajojë ndryshimet e jashtme. Këto dy aspekte janë të ndërlidhura ngushtë njëra me tjetrën. Vizioni nuk mund të arrihet pa një zhvillim të arsyeshëm të brendshëm të Gjykatës dhe ndikimit të ndërsjellë ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe forcave të jashtme shoqërore, ekonomike, kulturore dhe teknologjike.

Si rrjedhojë e kësaj, në pajtim me vizionin e lartpërmendur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka parashtruar vetes mision që të jetë:

Institucion profesional, kompetent dhe i pavarur, që është duke krijuar një traditë të re të paanshmërisë dhe të pavarësisë gjyqësore, si dhe të llogaridhënies së plotë në shërbim të qytetarëve të Kosovës;

Institucion transparent, që mbron me sukses të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve dhe të komuniteteve të Kosovës, duke gjykuar në mënyrë të drejtë dhe transparente, brenda juridiksionit të saj, dhe duke mbikëqyrur drejtësinë në ushtrimin dhe në përdorimin e kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta; dhe

Autoritet përfundimtar i rendit kushtetues të vendit, duke siguruar dhe duke mbështetur transicionin e Kosovës drejt të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Fjala hyrëse e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Prof. dr. Enver Hasani

Është kënaqësi e madhe për mua të prezantoj Raportin vjetor të Gjykatës për vitin e gjashtë me radhë, që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Sikurse edhe raportet pararendëse vjetore, Raporti vjetor për vitin 2014 prezanton një pasqyrë të aktiviteteve të Gjykatës gjatë vitit të kaluar dhe rendit të arriturat kryesore në vendosjen e autoritetit të saj dhe në ndërtimin e besimit të popullit të Kosovës. Ashtu sikurse edhe në vitet paraprake, këto të arritura kanë qenë të mundura falë punës së përkushtuar të gjyqtarëve të Gjykatës, Sekretarit të Përgjithshëm, këshilltarëve ligjorë dhe stafit të Gjykatës. Prandaj, i falënderoj nga zemra që të gjithë për përpjekjet e tyre të pareshtura për të çuar përpara objektivat e Gjykatës.

Gjatë vitit të kaluar, unë dhe gjyqtarët e Gjykatës zhvilluam vizita zyrtare në gjykata kushtetuese dhe në institucione të tjera shtetërore prestigjioze të vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera, siç janë: Shqipëria, Austria, Franca, Italia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia, me qëllim të shkëmbimit të mendimeve dhe të përvojave në drejtësinë kushtetuese dhe me qëllim të forcimit të marrëdhënieve profesionale e miqësore me institucione të tilla. Unë, po ashtu, isha i ftuar të mbaj ligjërata në Universitetin e Bolonjës dhe në Universitetin e Gracit, në "SMU Dedman School of Law" (SHBA), si dhe mora pjesë në Sesionin e 100-të Plenar të Komisionit të Venecias si anëtar përfaqësues i Republikës së Kosovës, së bashku me gjyqtaren Mr. sc. Arta Rama-Hajrizi, si zëvendësanëtare. Zëvendëskryetari i Gjykatës, dr. Ivan Čukalović, mori pjesë në Kongresin e 3-të të Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese, anëtare e së cilës Gjykata Kushtetuese u bë më 17 shtator 2014.

Gjatë vitit të kaluar, Gjykata vendosi për një numër rastesh të rëndësishme.

Dy nga këto raste (Rastet KI99/14 dhe KI100/14) kishin të bënin me kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për nominimin dhe për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Në rastin KI99/14, Gjykata konsideroi se anëtar i Panelit që ishte kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhej të ishte përjashtuar nga procedurat e votimit dhe të nominimit dhe duhej të ishte zëvendësuar me një anëtar tjetër. Përkritazi me rastin KI100/14, Gjykata konstatoi që parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar që ka qenë i diskriminuar në procedurën e testimit për shkak të gjinisë. Lidhur me të drejtën për procedurë të drejtë, Gjykata konsideroi se dështimi i KPK-së për të pranuar rregullat e veta të përcaktuara dhe për të siguruar një arsyetim të qartë në lidhje me aspektet thelbësore të argumentit faktik dhe ligjor procedural të parashtruesit të kërkesës, ishte në kundërshtim me të drejtën për një procedurë të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe, rrjedhimisht, procedura e zgjedhjes për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit duhej përsëritur, pa paragjykim të rezultatit të procedurës së përsëritur.

Një kërkesës tjetër e rëndësishme (Rasti KO103/14) u parashtrua nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e saj, Atifete Jahjaga, në bazë të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 9, dhe në bazë të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 3, të Kushtetutës, ku kërkohej nga Gjykata që të jepte interpretimin për disa nocione, siç janë: *"partia politike ose koalicioni që ka fituar zgjedhjet, e nevojshme (...) për të formuar Qeverinë, sipas së njëjtës procedurë dhe shumica në Kuvend"*, që përdoren në nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, dhe të specifikonte rendin e përparësisë ndërmjet nenit 84, paragrafi 14, dhe nenit 95 të Kushtetutës, pasi ato ndërliidhen me kompetencën e Presidentit për të mandatuar kandidatin për Kryeministër pas zgjedhjeve. Gjykata konkludoi se formulimi i përdorur e thotë qartë se emri i mandatarit duhet të propozohet nga partia politike ose nga koalicioni i regjistruar në Komisionin Qendror të

Zgjedhjeve (KQZ) dhe të ketë marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme. Koalicionet, të cilat nuk janë certifikuar nga KQZ-ja, nuk kanë të drejtë, sipas nenit 84 (14), të propozojnë mandatarin për Kryeministër. Rregulli dhe parimet demokratike, si dhe korrektësia politike, parashikueshmëria dhe transparencja, kërkojnë që partisë politike ose koalicionit që ka fituar numrin më të madh të vendeve, si rezultat i zgjedhjeve, t'i jepet mundësia të propozojë kandidatin për Kryeministër për formimin e Qeverisë. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr votat e nevojshme në Kuvend, është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që, pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër.

Gjithashtu, një kërkesë e rëndësishme që duhet përmendur është rasti KO119/14, i parashtruar nga 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku u kontestua Vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga procedura e ndjekur në seancën konstitutive të Kuvendit, më 17 korrik 2014. Parashtruesit e kërkesës pretendonin se Kryetari i legjislaturës së mëparshme kishte tejkaluar kompetencat e tij kushtetuese duke interpretuar gabimisht nocionin "grupi më i madh parlamentar". Parashtruesit e kërkesës më tej pohonin se vendimi i Kuvendit, duke përfshirë procedurën e ndjekur përgatitore lidhur me seancën konstituive, nuk ishte në pajtim me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, që parashihte se Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend dhe se ai/ajo zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Duke vlerësuar meritat e kërkesës, Gjykata konkludoi se vendimi i Kuvendit ishte jokushtetues dhe rrjedhimisht i pavlefshëm si për nga procedura e ndjekur ashtu edhe për nga përmbajtja, pasi nuk ishte grupi më i madh parlamentar ai që propozoi Kryetarin e Kuvendit; dhe që seanca konstituive e Kuvendit, e filluar më 17 korrik 2014, nuk ishte realizuar plotësisht, konkretisht nuk ishin zgjedhur Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Rrjedhimisht, Kuvendi duhej ta përfundonte seancën konstituive, duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët në pajtim me nenin 67.2 dhe nenin 64 [Struktura e Kuvendit], paragrafi 1, të Kushtetutës dhe në pajtim me Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene dhe në pajtim me këtë aktgjykim. Numri dhe llojllojshmëria e rasteve të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2014 përmendet gjetiu në këtë raport vjetor.

Më 15 tetor 2014, u mbajt ceremonia solemne e Vitit të Pestë Gjyqësor të Gjykatës, në praninë e gjyqtarëve dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë; të kryetarëve dhe të gjyqtarëve të këtyre gjykatave kushtetuese: të Lituanisë, të Luksemburgut, të Malit të Zi dhe të Sllovenisë; si dhe në prani të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Shqipërisë. Folësit kryesorë ishin: kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, dr. Dainius Zalimas; kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, Mag. Miroslav Mozetić; prof. dr. Luca Mezzeti, profesor në Universitetin e Bolonjës, Itali; dhe kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, prof. dr. Fejzullah Hasani.

Po ashtu, gjatë vitit të kaluar, Gjykata Kushtetuese miratoi një numër ndryshimesh në Rregulloren e saj të punës.

Përveç kësaj, sikurse edhe në vitet e kaluara, Gjykatës iu dha ndihmë e çmueshme nga USAID-i, nëpërmjet Projektit për Sundim të Ligjit (EROL); nga Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ), nëpërmjet Projektit të Reformës Ligjore; nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (Fondacioni IRZ) dhe nga EULEX-i. Dua t'i falënderoj përzemësisht për mbështetje të vazhdueshme nëpërmjet punëtorive, seminareve dhe aktiviteteve të tjera trajnuese, për të forcuar efikasitetin dhe funksionimin e Gjykatës. Posaçërisht, dua të falënderoj qeveritë e këtyre vendeve: Norvegji, Holandë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicër, Turqi, si dhe Komisionin Evropian, për donacionet zemërgjera, të cilat nëpërmjet International Management Group, apo në mënyra të tjera, u shfrytëzuan për të financuar tre gjyqtarët ndërkombëtarë dhe tre këshilltarët ndërkombëtarë në Gjykatë, në vitin 2014.

Sikurse edhe në vitet e kaluara, dëshiroj të theksoj se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të vazhdojnë të kryejnë punën e tyre në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës.

Prof. dr. Enver Hasani

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës



Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm, Milot Vokshi

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes Raportin vjetor 2014 të punës së Sekretariatit të Gjykatës, mekanizëm ky që mbështet Gjykatën Kushtetuese dhe që siguron funksionimin efikas të administratës së Gjykatës.

Raporti pasqyron veprimet dhe aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Sekretariati, në drejtim të përmbushjes së objektivave nga Planin vjetor i punës për vitin 2014 dhe të objektivave të parashikuara në Planin Strategjik të Gjykatës për periudhën 2014-2017.

Sikundër edhe viteve të mëparshme, edhe më 2014, Sekretariati ishte i angazhuar me përkushtim të madh:

- Në arritjen e objektivave të punës
- Në përmbylljen me sukses të projekteve të parapara në Planin e punës për vitin 2014, dhe
- Në Planin Strategjik të Gjykatës për periudhën 2014-2017

Në mënyrë të veçantë, Sekretariati ishte i fokusuar në plotësimin e pozitave të punës, në aftësimin dhe në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në zhvillimin, në hartimin e në zbatimin e mëtejme të rregullave dhe të procedurave të punës, për të siguruar një performansë sa më të lartë të Sekretariatit, brenda përgjegjësi që ka.

Duke zhvilluar aktivitetet e planifikuara dhe duke realizuar synimet e parapara në afate kohore, Sekretariati ka tejkaluar me sukses ballafaqimin me sfidat dhe ka arritur plotësisht objektivat e punës.

Përmbushja e objektivave të identifikuar është fryt i punës ekipore të personelit të Sekretariatit, prandaj, sikurse viteve që shkuan, përfitoj nga rasti t'i shpreh mirënjohje gjithë personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës, si dhe në sigurimin e funksionimit me efektivitet të lartë të Gjykatës.

Një falënderim të veçantë e meritojnë donatorët, të cilët, edhe në vitin 2014, me asistencën e tyre, ndikuan në arritjen e sukseseve të përgjithshme të Gjykatës, e në veçanti në hartimin e Planit Strategjik të zhvillimit të Gjykatës për periudhën 2014-2017.

Veçmas, në emrin tim dhe në emër të stafit të Sekretariatit, falënderoj gjyqtarët dhe kryetarin e Gjykatës, prof. dr. Enver Hasani, për inkurajimin, për përkrahjen dhe për mbështetjen pa rezervë, si dhe për udhëzimet e qarta dhe profesionale që na kanë ofruar në tejkalimin e sfidave, përdërisa përkushtimi i pashembullt dhe profesionalizimi i tyre, i treguar në interpretimin e Kushtetutës, vazhdon ta mbajë Gjykatën Kushtetuese ndër institucionet më të fuqishme, më të respektuara dhe me besueshmërinë më të lartë në vend.

Sekretariati, po ashtu, edhe në vitin 2015, do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e Planit të punës dhe të Planit Strategjik për periudhën 2014-2017.

Milot Vokshi

Sekretar i Përgjithshëm

Raport vjetor i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2014

Hyrje

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, dhe është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Në vitin 2014, Gjykata Kushtetuese pranoi 187 kërkesa të reja.

Nga kërkesat e parashtruara në Gjykatë në vitin 2014, ajo vendosi për 226 kërkesa, publikoi 208 vendime në ueb-faqen e Gjykatës dhe ua dorëzoi palëve.

208 vendime të Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës dhe me rregullin 14 (3) i të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjykata Kushtetuese aprovoi raportin e saj vjetor për vitin 2014, në seancën administrative të mbajtur më ____ 2015.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me rregullin 14 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sekretariati organizoi mbarëvajtjen e 5 (pesë) seancave administrative, ku u morën 15 (pesëmbëdhjetë) vendime. Ndër vendimet më të rëndësishme ishin:

- Aprovimi i Raportit Vjetor të Punës për vitin 2013;
- Aprovimi i Planit Vjetor të Punës të Sekretarit të Përgjithshëm për vitin 2014;
- Aprovimi i ndryshimeve në Rregulloren e Punës të Gjykatës;
- Zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Themelimi i Zyrës për Komunikim dhe Informim.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare



**Prof. dr. Enver Hasani,
kryetar**



**Prof. Dr. Ivan
Čukalović,
zëvendëskryetar**




**Robert Carolan
J.D., gjyqtar**



**Dr. Altay Suroy,
gjyqtar**



**Dr. Almiro
Rodrigues, gjyqtar**



**Prof. dr. Snezhana
Botusharova-
Doicheva, gjyqtare**



**Dr. sc. Kadri Kryeziu,
gjyqtar**



**Mr. sc. Arta Rama-
Hajrizi, gjyqtare**

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 15 të Rregullores së punës, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili sipas nenit 12.4, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë. Struktura organizative e tij përbëhet nga:

- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Njësia e Prokurimit (NJP);
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe e Multimedieve (NJTIKM); dhe
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB).

Ndërsa në realizim të objektivit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2014-2017 dhe në zbatim të vendimit të miratuar në seancën administrative, Nr. KK-SP 352/14, të 7 nëntor 2014, me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, themelohet:

- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI)

Funksionimi i Njesisë Ligjore (NJL), që përfshin pozitat e këshilltarëve juridikë dhe personelin tjetër ligjor, si dhe struktura dhe organizimi i saj, janë rregulluar me Udhëzimin për praktikën, i miratuar nga Gjykata. Këshilltarët juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Sekretariati i ka realizuar këto objektiva të vitit:

- Implementimi i Planit Strategjik 2014-2017;
- Hartimi dhe aprovimi i Rregullores për organizimin e brendshëm të GJKK-së, Nr. 01/2014;
- Hartimi dhe aprovimi i Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës në GJKK , Nr. 02/2014;

Sekretariati gjithashtu publikoi:

- Raportin e tremujorit të katërt, tetor-dhjetor 2013;
- Raportin e tremujorit të parë, janar-mars 2014;
- Raportin e tremujorit të dytë, prill-qershor 2014;
- Raportin e tremujorit të tretë, korrik-shtator 2014;
- Buletinin e vendimeve 2013, në tri gjuhë;
- Udhëzimin për përdorimin e veturave zyrtare, nr. 01 /2014, dhe
- Udhëzimin për përdorimin e telefonave fiks dhe mobilë, nr. 02/14.


**Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore
(DABNJ)**

I. Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ)


I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

- Në bazë të planit operacional të rekrutimit, janë përgatitur dhe publikuar gjithsej 4 (katër) konkurse publike, të cilat kanë përfshirë gjithsej 3 (tri) vende pune dhe 12 pozita për praktikantë.
- Pas zhvillimit me sukses të procedurave të rekrutimit, janë rekrutuar gjithsej 2 (dy) punonjës, nga ta 1 (një) Sekretar i Përgjithshëm dhe 1 (një) Redaktor/lektor për gjuhën serbe. Njëkohësisht, janë përgatitur dhe zhvilluar procedurat e brendshme të avancimit për 1 (një) pozitë pune, Këshilltar Juridik (Senior). Për këtë pozitë, komisioni përzgjedhës ka rekomanduar kandidatin më të suksesshëm, dhe në seancën administrative të radhës do të shqyrtohet dhe vendoset për kandidatin e propozuar.
- Gjithashtu, pas përzgjedhjes, kanë mbajtur punën praktike 12 (dymbëdhjetë) praktikantë në kohëzgjatje prej nga tre muaj.
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve, nga numri prej 61 vetash, sa janë të lejuar me buxhetin e vitit 2014, arrin në 59, duke përfshirë këtu, gjyqtarët dhe këshilltarët juridikë. Gjykata ka funksionuar pa një gjyqtar edhe gjatë këtij viti..
- Gjatë procesit të aplikimit dhe rekrutimit, me konsekuencë janë ndjekur dhe zbatuar politikat jodiskriminuese, përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor dhe shumetnik të Kosovës. Në përmbyllje të konkursit, gjithnjë është bërë verifikimi nëse për pozita të caktuara kanë aplikuar kandidatë me përfaqësim të barabartë gjinor dhe etnik.
- Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve prej 59 vetash, 32 janë të gjinisë mashkullore, apo 56%, ndërsa 27 të gjinisë femërore, gjegjësisht 44%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale 50 janë shqiptarë (83%), 5 serbë (10%), 2 turq (3%), 1 boshnjak (2%) dhe 1 malazias (2%).

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:




Numri i të punësuarve sipas gjinisë:



II. Ngritja e kapaciteteve

- Me qëllim të ngritjes së mëtejme të kapaciteteve dhe aftësive vepruese, si dhe të zbatimit të politikave të aftësimit të nëpunësve të Gjykatës Kushtetuese bazuar edhe në Planin Strategjik 2014-2017, është vazhduar me zbatimin e Programit kornizë të trajnimeve për nëpunësit e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë periudhë janë organizuar dhe realizuar 7 (shtatë) punëtori brenda vendit, 6 (gjashtë) punëtori jashtë vendit, 5 (pesë) pjesëmarrje në konferencat ndërkombëtare jashtë vendit, 4 (katër) trajnime brenda vendit, 3 (tri) trajnime jashtë vendit, 2 (dy) vizita studimore jashtë vendit, dhe mësim të gjuhëve të huaja, me 8 (tetë) pjesëmarrës.

Numri i pjesëmarrjes në punëtori, konferenca, trajnime dhe kurse, brenda dhe jashtë vendit:



III. Mbështetja administrative dhe logjistike

- Janë ofruar dhe siguruar shërbimet e kërkuara në sferën e logjistikës, transportit dhe kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të IT-së, si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
- Është kryer regjistrimi i 373 faturave në Sistemin Free Balance, pas furnizimit me material shpenzues dhe me pajisje të IT-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të GJKK-së;
- Është bërë mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës si dhe janë përpiluar me kohë raportet mujore lidhur me shpenzimin e derivateve;
- Janë përpiluar dhe adresuar shkresat përkatëse drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative, pagave dhe mëditjeve.
- Janë ndërmarrë aktivitetet shtesë, dhe monitoruar procesi i zbatimit të Planit Strategjik 2014-2017.

Në sferën e shërbimeve të bibliotekës

Gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2014, në bibliotekën e Gjykatës Kushtetuese, janë pranuar këto libra dhe janë kryer aktivitetet si vijon:

- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 53, 54, 55, 56, 57 të muajit dhjetor 2013, 3 (tri) kopje; nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 të muajit janar 2014, 3 (tri) kopje; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 të muajit shkurt 2014, 3 (tri) kopje; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 16,17,18, 19. 20. 21, 22, 23, 24, 25, mars 2014 me nga 3 (tri) kopje; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 26,27,28,29,30,31, të muajit maj 2014, 3 (tri) kopje; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38 qershor 2014, 3 (tri) kopje; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 41, 42, 43, 44, të muajit tetor, 3 (tri) kopje; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 45, 46 me nga 3 (tri) kopje, nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- 3 (tri) raporte të politikës monetare dhe stabilitetit financiar, si dhe 8 (tetë) botime tjera nga lëmi bankar, janë dhuruar nga Banka e Shqipërisë.
- 2 (dy) përmbledhje aktesh juridike (Indeksi – 2013 dhe Indeksi 2014), të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, për vitin 2013 dhe 2014, me nga 3 (tri) kopje.
- 2 (dy) gazeta Zyrtare të UNMIK-ut, (volume 2-2003 dhe volume 3-2003), me 1 (një) kopje në tri gjuhët.
- 2 (dy) Buletinë të Praktikës Gjyqësore Kushtetuese (Bulletin on Constitutional Case-Law / Edition 2013 / 1; / Edition 2013/2 dhe Edition speciale, Grands arrêts-CEJ) me nga 2 (dy) kopje, nga Komisioni i Venecias.
- 1 (një) Raport vjetor 2013/Gjykata Kushtetuese në shtypin ditor të Kosovës (9 copë shqip, 4 copë anglisht); 1 (një) Raport vjetor 2013 (me një kopje shqip, anglisht, serbisht) nga Trusti; 1 (një) Raport vjetor 2013 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut - (me një kopje shqip, anglisht, serbisht); 1 (një) Raport vjetor 2013, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (me një kopje shqip, anglisht, serbisht); 1 (një) Raport tremujor prill-qershor i Gjykatës Kushtetuese 2013 (shqip, anglisht, serbisht me gjashtë kopje); 1 (një) Raport vjetor 2013 nga KPA (me një kopje shqip, anglisht, serbisht); 1 (një) Raport vjetor i Panelit për shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, 1 janar – 31 dhjetor 2013 Human Rights Review Panel (Skriptë).
- 1 (një) Vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (me gjashtë kopje); 2 kushtetuta, dhe 3 (tri) botime tjera nga lëmi kushtetues, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.

- 12 (dymbëdhjetë) libra, doracakë dhe botime tjera nga lëmi juridik / kushtetues janë dhuruar nga donator të ndryshëm, me rastin e vizitave të stafit tonë në gjykatat tjera të rajonit dhe botës.
- 6 (gjashtë) botime juridike lidhur me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, botime të IRZ-së, GIZ-it në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
- 2 (dy) revista periodike: “ Shenja” dhe ”Al Meridiani Shqiptar”, nga Maqedonia dhe Shqipëria.
- 1 (një) libër juridik dhe 1 (një) pjesë artikulli të revistës, nga Këshilli Kushtetues francez (Le Conseil Constitutionnel).
- 1 (një) Raport vjetor 2013 dhe një broshurë, nga Këshilli shtetëror francez (The Conseil d’Etat) in a few words- (broshurë).

**Departamenti i Përkrahjes Profesionale
(DPP)**

II. Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP)

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës, të transkriptimit dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese dhe në gjuhët në të cilat punon GJKK-ja.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit, të redaktimit, të lekturës (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe), të transkriptimit dhe të përkthimit aty për aty (simultan). Kështu, nëpër DPP kanë kaluar 18.089 faqe, ose mesatarisht 73 faqe në ditë, të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për heqje nga lista, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

DPP-ja ka transkriptuar 104 faqe të regjistrimeve audio.

Përkthyesit kanë bërë 566 orë e 25 minuta përkthime simultane në takime të rregullta, në seanca të Gjykatës, në seanca administrative, në intervista të kandidatëve për pozitë e shpallura nga GJKK-ja, si dhe në takime të tjera.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në shqip, në serbisht, në anglisht dhe në turqisht.

Objektivat

Objektivat që ka arritur DPP-ja janë këto:

- Standardizimi i të gjitha dokumenteve zyrtare dhe i të gjitha vendimeve që mbajnë vulën e Gjykatës Kushtetuese;
- Eliminimi i mospërputhjeve në aktgjykime, në aktvendime, në raporte paraprake e në dokumente të tjera të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- Përditësimi i fjalorit të veçantë terminologjik tregjuhësh të shprehjeve të Gjykatës Kushtetuese;
- Nxitja në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për të vënë në praktikë menaxhimin dhe planifikimin me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe për të ngritur bashkëpunimin ndërmjet departamenteve;
- Bashkëpunimi me operatorin, sa i përket përkthimit (jashtë Gjykatës dhe në Gjykatë); dhe
- Jetësimi me sukses i të gjitha objektivave që dolën për vitin 2014 nga Plani strategjik i GJKK-së 2014-2017.

**Departamenti i Regjistrimit të Lëndëve, Statistikës dhe Arkivit
(DRLSA)**

III. Departamenti i Regjistrimit të Lëndëve, Statistikës dhe Arkivit (DRLSA)


1. Statusi i lëndëve

Gjatë vitit 2014, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 289 kërkesa/lëndë:

- 6 kërkesa janë bartur nga viti 2012, të cilat janë zgjidhur;
- 96 kërkesa janë bartur nga viti 2013, të cilat janë zgjidhur;
- 187 kërkesa janë pranuar në vitin 2014, prej të cilave 124 janë zgjidhur.

Gjithsej janë vendosur 226 kërkesa ose 78.20% e të gjitha rasteve të pazgjidhura.

208 nga 226 kërkesat e zgjidhura gjatë vitit 2014 janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët (përfshirë edhe 37 vendimet e vitit 2013, të cilat ishin në proces të hartimit), ndërsa 59 kërkesa të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.



Në vijim janë paraqitur aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë vitit 2014:

- Aktgjykim, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014, rasti KO119/14.
- Aktgjykim, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, rasti KI99/14 dhe KI100/14.
- Aktgjykim, përkritazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84.14 [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rasti KO103/14.
- Aktgjykim, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 7/2013, të 19 tetorit 2013, rasti KI 10/14.

- Aktgjykim, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013, rasti KI89/13.
- Aktgjykim, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 324/12, të 21 dhjetorit 2012, rasti KI94/13.
- Aktgjykim, vlerësimi i kushtetutshmërisë për mospërmbarimin e Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012 dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011, rasti KI187/13.
- Aktgjykim, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve Rev. Mlc. nr. 329/2012, të 24 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 356/2009, të 20 janarit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe të Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 11 majit 2012, rasti KI200/13.
- Aktgjykim, vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11 mars 2014, me shkrësën Nr. 04-DO-2186, rasti KO44/14.
- Aktgjykim, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 492/2008, të 10 marsit 2009, rasti KI138/11.

2. Parashtrimi i kërkesave

Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës, dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efikase, efektive dhe të paanshme. 187 kërkesa janë pranuar gjatë vitit 2014, që do të thotë se janë pranuar mesatarisht 15,6 kërkesa në muaj.

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

- 161 kërkesa individuale (nga personat fizikë), ose 86,1%; dhe
- 26 kërkesa nga autoritet të tjera publike (personat juridik), ose 13,9%.

3. Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 13 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 8 dhe 33 të Rregullores së punës të Gjykatës. Përfundim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e Masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 7 të Rregullores së punës.

4. Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës


Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike a fetare, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Qasja e individëve tregohet me sa vijon:


- 141 kërkesa nga shqiptarët, ose 75,4%;
- 12 kërkesa nga serbët, ose 6,4%;
- 4 kërkesa nga boshnjakët, ose 2,1%;
- 2 kërkesa nga malazezët, ose 1,1%;
- 2 kërkesa nga nacionalitetet e tjera, ose 1,1%;

24 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet të tjera publike (personat juridikë), ose 13,9%.

Struktura etnike e paraqitësve të kërkesave, paraqitur në numër dhe përqindje:



Shkeljet e supozuara, sipas llojit të shkeljeve:



5. Llojet e shkeljeve të supozuara

187 kërkesat e pranuar në vitin 2014 kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara nga:


- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve], 1 rast ose 0,5 %;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 25 raste ose 13,4 %;
- Neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë], 1 rast ose 0.5%;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 86 raste ose 46.0%;
- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 3 raste, ose 1.6%;
- Neni 36 [E drejta e privatësisë], 1 rast ose 0.5%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 1 rast, ose 0.5%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 30 raste, ose 16.0%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 14 raste ose 7.5%;
- Neni 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale], 4 raste, ose 2.1% ;
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 6 raste, ose 3.2% ;

- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të gjyqësorit, 4 raste, ose 2.1%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të autoriteteve tjera publike, 10 raste ose 5.3%; dhe
- Shkelje të tjera, 1 rast ose 0,5 %.

6. Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 161 ose 86,1 % kërkesa kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave, dhe
- 26 ose 13,9 % kërkesa kanë të bëjnë me institucionet shtetërore.

Shkelësit e supozuar të të drejtave




7. Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë vitit 2014, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 2 seanca publike dëgjimore, 41 seanca plenare, dhe 193 kolegje shqyrtuese në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me vendime, aktvendime, aktgjykime dhe masa të përkohshme:

- 10 Aktgjykime ,
- 175 Aktvendime ;
- 2 Vendime për Masë të Përkohshme,
- 3 Vendime për Refuzim të kërkesës për Masë të Përkohshme, dhe
- 8 Vendime për heqje të kërkesës nga lista .

Struktura e vendimeve në numër dhe në përqindje



**Departamenti i Buxhetit dhe Financave
(DBF)**

IV. Departamenti i Buxhetit dhe Financave (DBF)

Departamenti i Buxhetit dhe Financave

Mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese të aprovuara për vitin 2014 janë **1,552,741.00€**, ndërsa pas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 07/172 i 27 shkurtit 2014, për uljen e shpenzimeve në kategorinë buxhetore operative në nivelin e 15%, në nëntor nga projekti me kod 13992 janë marrë nga Ministria e Financave mjete financiare në shumë prej 46,835.00€, buxheti i Gjykatës Kushtetuese për vitin fiskal 2014 është **1,416,911.00€** dhe sipas strukturës përkatësisht kategorive ekonomike, pasqyrohen në paraqitjen tabelare.¹

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
859,439.00€	510,797.00€	8,500.00€	38,175.00€	0.00€	1,416,911.00€

Buxheti i aprovuar 2014, alokimi dhe realizimi për periudhën Janar – Dhjetor

	Buxheti i aprovuar 2014 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	859,439.00	859,439.00	837,307.22	97.42	97.42
Mallra dhe shërbime	510,797.00	510,797.00	510,751.33	99.99	99.99
Shpenzime komunale	8,500.00	8,500.00	7,073.50	83.21	83.21
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	38,175.00	38,175.00	29,767.47	77.97	77.97
Gjithsej	1,416,911.00	1,416,911.00	1,384,899.52	97.74	97.74

¹ Donacion nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë në shumë 22,457.25€, ngritja e kapaciteteve në sektorin e përkthimeve, donacioni është përfituar në vitin fiskal 2013.

Në vitin fiskal 2014 Gjykata Kushtetuese ka përfituar donacion në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga Qeveria Holandeze në shumë prej 89,900.00€, mjetet janë dedikuar për pagesën e këshilltarëve ndërkombëtar të cilët kryejnë punë në Gjykatën Kushtetuese. Shuma e mjeteve të përfituara është 84,600.00€.

Donacion i përfituar nga Qeveria Holandeze në vitin fiskal 2014

	Donacion i aprovuar 2014 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Mallra dhe shërbime	89,900.00	89,900.00	84,600.00	94.10	94.10
Gjithsej	89,900.00	89,900.00	84,600.00	94.10	94.10

Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën Janar – Dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm, pjesëmarrja e alokimit në vitin fiskal 2014 ka qenë 1,416,911.00€ e shprehur në përqindje 100%.

	Janar- Shtator €	Tetor €	Nëntor €	Dhjetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	644,579.25	71,619.91	71,783.17	71,456.67	859,439.00	100
Mallra dhe shërbime	445,000.00	20,500.00	34,990.00	10,307.00	510,797.00	100
Shpenzime komunale	6,900.00	600.00	500.00	500.00	8,500.00	100
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	38,175.00	0.00	0.00	0.00	38,175.00	100
Gjithsej	1,134,654.25	92,719.91	107,273.17	82,263.67	1,416,911.00	71.71

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit në vitin fiskal 2014 ka qenë 1,384,899.52€, e shprehur në përqindje 97.74%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	859,439.00	837,307.22	22,131.78	97.42
Mallra dhe shërbime	510,797.00	510,751.33	45.67	99.99
Shpenzime komunale	8,500.00	7,073.50	1,426.50	83.21
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	38,175.00	29,767.47	8,407.33	77.97
Gjithsej	1,416,911.00	1,384,899.52	32,011.48	97.74

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	60	71,619.92	62,437.79	9,182.13
Shkurt	60	71,619.92	63,482.64	8,137.28
Mars	60	71,619.91	62,631.39	8,988.52
Prill	59	71,619.91	69,162.97	2,456.94
Maj	59	71,619.91	75,339.50	-3,719.59
Qershor	59	71,619.91	72,474.72	-854.81
Korrik	59	71,619.92	73,306.28	-1,686.36
Gusht	59	71,619.92	72,991.24	-1,371.32

Shtator	59	71,619.92	70,714.76	905.16
Tetor	58	71,619.92	70,885.81	734.11
Nëntor	59	71,783.17	71,783.17	0
Dhjetor	59	71,456.67	72,096.95	-640.28
Gjithsej		859,439.00	837,307.22	22,131.78

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	85,000.00	85,000.00	63,302.31	21,697.69
Shkurt	55,000.00	55,000.00	57,545.17	-2,545.17
Mars	55,000.00	55,000.00	50,012.02	4,987.98
Prill	50,000.00	50,000.00	42,035.04	7,964.96
Maj	45,500.00	45,500.00	60,246.98	-14,746.98
Qershor	40,000.00	40,000.00	39,158.75	841.25
Korrik	35,000.00	35,000.00	50,337.79	-15,337.79
Gusht	35,000.00	35,000.00	15,207.76	19,792.24
Shtator	44,500.00	44,500.00	33,440.06	11,059.94
Tetor	20,500.00	20,500.00	55,006.11	-34,506.11
Nëntor	34,990.00	34,990.00	25,307.13	9,619.87
Dhjetor	10,307.00	10,307.00	19,089.21	-8,782.21
Gjithsej	510,797.00	510,797.00	510,751.33	45.67

Buxheti i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Pajisjet e TI-së	11132	10,600.00	10,598.92	1.08
Mobilë	11133	4,500.00	4,320.00	180.00
Sistemi VOIP	13993	23,075.00	14,848.55	8,226.45
Sistemi Audio dhe Video 4 kanalësh	13992	0.00	0.00	0.00
Gjithsej:		38,175.00	29,767.47	8,407.53

Realizimi i buxhetit për projekte kapitale

Realizimi i buxhetit në kategorinë e projekteve kapitale të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	0.00	0.00	0.00	0.00
Shkurt	10,600.00	10,600.00	10,598.92	1.08
Mars	0.00	0.00	0.00	0.00
Prill	27,575.00	27,575.00	27,575.00	0.00
Maj	0.00	0.00	0.00	0.00
Qershor	0.00	0.00	0.00	0.00
Korrik	0.00	0.00	0.00	0.00
Gusht	0.00	0.00	0.00	0.00
Shtator	0.00	0.00	0.00	0.00
Tetor	0.00	0.00	0.00	0.00
Nëntor	0.00	0.00	4,320.00	180.00
Dhjetor	0.00	0.00	14,848.55	8,226.45
Gjithsej	38,175.00	38,175.00	29,767.47	8,407.53

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë, te shpenzimet e komunaleve për nëntëmuja e parë:²

Shpenzimet e komunaleve	Destinimi	Kodi ekonomik	Buxheti i aprovuar €	Alokimet janar – dhjetor	Realizimi €
	Shpenzimet e telefonisë fikse	13250	8,500.00	7,073.50	1,426.50

² Shpenzimet e komunaleve nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

Njësia e Prokurimit
(NJP)

V. Njësia e Prokurimit (NJP)

Në pajtim me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik, Nr. 04/L-042, neni 8, pika 2, Autoriteti Kontraktues më 12 janar 2014, ka dorëzuar planin final të prokurimit për vitin 2014 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik.

Në pajtim me nenin 10, pika 1, Autoriteti Kontraktues më 12 janar 2015, do të dorëzojë raportin vjetor të prokurimit publik për vitin 2014 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Në pajtim me nenin 8, pika 1, Autoriteti Kontraktues më 29 tetor 2014 ka dorëzuar planin preliminar të prokurimit për vitin 2015 dhe në pajtim me nenin 8, pika 2, të këtij ligji, më 14 janar 2015, do të dorëzohet plani final i prokurimit për vitin 2015 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP).

Në mbështetje të Planit strategjik të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 2014-2017, si dhe në mbështetje të planit final të prokurimit të vitit 2014, Njësia e Prokurimit ka iniciuar gjithsej 20 aktivitete. Aktivitetet e prokurimit i kemi klasifikuar sipas vlerës, sipas tipit dhe sipas procedurës. Në vijim paraqesim:

Aktivitet i prokurimit me vlerë të madhe (procedurë e hapur):

Aktivitet i prokurimit me vlerë të madhe në vitin 2014 është iniciuar 1 (një), i ndarë në dy lote, është nënshkruar 1 (një) kontratë për të 2 (dy) lotet.

Titulli i kontratës:

1. "Shërbime të përkthimit me shkrim dhe me gojë, nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, në gjuhën serbe, në gjuhë të tjera sipas nevojës dhe anasjelltas, për nevojat e GJKK-së, Lot I dhe II"

Aktivitete të prokurimit me vlerë të mesme (Procedurë e hapur):

Aktivitete të prokurimit me vlerë të mesme në vitin 2014 janë iniciuar 7 (shtatë). 1 (një) aktivitet ka qenë i ndarë në 2 (dy) lote. Janë nënshkruar 7 (shtatë) kontrata, ndërsa 1 (një) planifikohet të nënshkruhet në vitin 2015.

Titulli i kontratës:

1. "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative",
2. "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Mercedes",
3. "Lot 1 : Servisimi dhe mirëmbajtja e fotokopjeve Konica Minolta bizhub 421 dhe Lot 2 : Servisimi dhe mirëmbajtja e serverëve dhe pjesëve harduerike",
4. "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Peugeot 308",
5. "Shërbime të transkriptimit nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, në gjuhën serbe, në gjuhë tjera sipas nevojës dhe anasjelltas për nevojat e GJKK-së",

6. "Furnizimi dhe implementimi i sistemit Voice Over Internet Protokol (VOIP), në Gjykatën Kushtetuese",
7. "Shërbime të mirëmbajtjes dhe të pastrimit të hapësirave dhe të objekteve të GJKK-së".

Aktivitete të prokurimit me vlerë të vogël (Procedurë e kuotimit të çmimeve):

Aktivitete të prokurimit me vlerë të vogël janë iniciuar 4 (katër), dhe janë nënshkruar po aq kontrata.

Titulli i kontratës:

1. "Furnizim me aparat mobil (telefon) për nevoja të GJKK-së",
2. "Sigurimi i automjeteve zyrtare TPL, TPL Plus dhe Kasko e plotë EU",
3. "Shërbime të autolarjes së veturave zyrtare të GJKK-së",
4. "Furnizim me karrige zyrtare për nevoja të stafit të GJKK-së".

Aktivitete të prokurimit me vlerë të vogël (Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë):

Aktivitete të prokurimit me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë janë iniciuar 2 (dy), ndërsa janë nënshkruar 4 (katër) kontrata.

Titulli i kontratës:

1. "Shërbimet për shpalljen e konkurseve dhe të publikimeve të tjera në gazeta ditore",
2. "Shërbime të harmonizimit dhe të lektorimit të aktgjykimeve, të aktvendimeve dhe të vendimeve të tjera, në versionin origjinal të dokumentit (në gjuhën në të cilën është punuar dokumenti)".

Aktivitete të prokurimit me vlerë minimale (Procedurë me vlerë minimale):

Aktivitete të prokurimit me vlerë minimale janë iniciuar 6 (gjashtë) dhe janë nënshkruar po aq marrëveshje.

Titulli i kontratës:

1. "Furnizim me libra",
2. "Dislokimi i rrethojave metalike përbrenda hapësirave të parkingut të GJKK-së",
3. "Dhurata për festën e 8 Marsit për zyrtarët e gjinisë femërore të GJKK-së",
4. "Furnizim me gardërobë për vozitës",
5. "Furnizim me libra specifik për Vitin gjyqësor",
6. "Sigurimi i automjetit zyrtar TPL, TPL plus dhe kasko e plotë EU, për veturën Peugeot 308".

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara sipas kontratave të nënshkruara me procedura të rregullta të prokurimit:

Përshkrimi	Shuma e kontratave të nënshkruara	Shuma e paguar
Procedurë e hapur	42,035.90	42,035.90
Procedurë e kufizuar	0.00	0.00
Konkurs projektimi	0.00	0.00
E negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës	0.00	0.00
E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	516.00	516.00
Kuotimi i çmimeve	19,230.94	19,230.94
Procedurë për vlerë minimale	4,789.40	4,789.40
a) 2014	<u>66,572.24</u>	<u>66,572.24</u>
Shuma e përgjithshme e pagesave të kontratave afatgjatë:		
b) 2011	<u>212,511.39</u>	<u>212,511.39</u>
c) 2012	<u>89,922.37</u>	<u>89,922.37</u>
d) 2013	<u>47,215.00</u>	<u>47,215.00</u>
Shuma e përgjithshme (a+b+c+d)	<u>416,221.00</u>	<u>416,221.00</u>

**Njësia e Teknologjisë së Informacionit dhe Multimedive
(NJTIKM)**

VI. Njësia e Teknologjisë së Informacionit dhe Multimedive (NJTIKM)

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multimedive, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatë Kushtetuese.

Gjatë vitit 2014, ka realizuar projekte dhe detyra sipas planit dhe përgjegjësi të saj, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike, në përputhje me planin strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

Projektet e realizuara nga NJTIKM

1. Transferimi i domenit të e-postave;

Projekti për transferimin e domenit është inicuar duke u bazuar në pavarësinë e Gjykatës me qëllim të komunikimit nëpërmjet postës elektronike me domen të veçantë të Gjykatës. Ky projekt është përfunduar sipas planit të paraparë në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit ASHI, domeni i Gjykatës është ndryshuar nga domeni *emri.mbiemri@rks-gov.net* në *emri.mbiemri@gjk-ks.org*, të gjitha llogaritë janë transferuar me sukses.

2. Avancimi i sistemit CDMS në ueb-aplikacion (donacion);

Projekti për avancimin e sistemit CDMS (Case Data Management System), është projekt për migrimin dhe avancimin e sistemit nga aplikacioni ekzistues Windows në Ueb aplikacion, me qëllim të modernizimit dhe të rritjes së kapacitetit të data bazës për regjistrimin dhe menaxhimin e lëndëve në Gjykatën Kushtetuese. Projekti është inicuar dhe propozuar nga Gjykata Kushtetuese për mundësin e financimit nga organizata EROL-USAID, ky projekt është pranuar për financim dhe është në fazën përfundimtare.

3. Sistemi i telefonisë VOIP (Voice Over Internet Protokol)

Projekti për implementimin e sistemit VOIP në Gjykatën Kushtetuese është realizuar në pajtim me planin e Njesisë për vitin 2014. Ky projekt ka për qëllim kalimin e sistemit të telefonisë analog në sistemin IP-telefoni, që do të thotë komunikimin përmes Internet protokollit, si dhe ngritjen e performancës gjatë komunikimit me sistemin e telefonisë fikse.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Publikimi në Ueb Faqen e Gjykatës *case summary* për të gjitha vendimet e publikuara gjatë vitit 2013.
- Konfigurimi i politikave të reja për sigurinë e e-postave dhe llogaritë e punonjësve të Gjykatës.
- Intervenime teknike në pajisjet e punonjësve sipas kërkesave.

- Përkujdesje dhe ofrim të shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë Informative dhe komunikimit.
- Përkujdesje në mbarëvajtjen e sistemit të përkthimit simultant dhe incizimin e seancave gjyqësore gjatë mbajtjes së tyre.
- Rikonfigurimi i softuerit të sistemit audio për incizimin e seancave në sallën e gjyqimit.
- Dokumentimi dhe dizajnimi i infrastrukturës të sistemit të teknologjisë në Gjykatë.
- Janë publikuar 208 vendime në Ueb Faqe në tri gjuhët zyrtare.
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e sistemit të domenit të Gjykatës dhe krijimi i politikave të sigurisë në serverët.
- Përkujdesje në krijimin e kopjeve (back-up) të domenit të Gjykatës dhe sistemit të CDMS-it.

Auditimi

VII. Auditimi

1. Auditimi I brendshëm

Bazuar në planin vjetor për vitin 2014, NJAB ka përfunduar me kohë të gjitha auditivet e planifikuara, si:

- Menaxhimi i personelit,
- Funksionimi i kontrollit të brendshëm në Departamentin për Përkrahje Profesionale,
- Funksionimi i Teknologjisë së Informacionit në GJKK,
- Menaxhimi i shpenzimeve, dhe
- Menaxhimi i prokurimit.

Me kërkesë të menaxhmentit, u zhvilluan edhe komentet e auditorit për dy raportet e para tremujore vjetore nga departamentet e institucionit.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB, që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës, dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi, janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve, dhe në rastin e parë të mundshëm është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga auditori i brendshëm, gjithashtu edhe nga auditorët e përgjithshëm, e kjo ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar planin për vitin 2014 dhe ka përmbyshur kërkesat shtesë, si:

- Planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2015-2017;
- Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2015;
- Komentet dhe mendimin e Auditorit për tremujorët e parë të vitit 2014 dhe për raportin vjetor të vitit paraprak;
- Vizitat përcjellëse për implementimin e rekomandimeve, dhe
- Arsimin e vazhdueshëm profesional.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm - organ i pavarur këshillëdhënës - në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ Nr. 11-2010 për Themelimin dhe Funksionimin Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik,
- Statutin e KAB,
- Praktikën e mira, dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Gjatë vitit 2014 ka mbajtur 4 (katër) takime dhe siguron mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

Për vitin 2014, Komiteti i Auditimit ka arritur në përfundim se Gjykata Kushtetuese funksionon në nivel të kënaqshëm, ka vlerësuar bashkëpunimin menaxhment – NJAB, ku me kohë adresohen dhe implementohen rekomandimet si nga Auditori i përgjithshëm, po ashtu edhe nga Auditori i brendshëm.

3. Auditimi i jashtëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm(ZAP), për pasqyrat financiare të vitit 2014, ka kryer fazën e përkohshme të auditimit në muajin dhjetor 2014. Gjykata ka pranuar Memon e auditimit, ku konstatohet se Gjykata Kushtetuese ka dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Progresi i bërë lidhur me adresimin e rekomandimeve, tregon gatishmërinë e menadamentit për të përmirësuar në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm.

Njësia Ligjore
(NJL)

VIII. Njësia Ligjore (NJL)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës punëson një numër të juristëve në nivele të ndryshme, të cilët përkrahin punën profesionale të gjyqtarëve dhe të administratës së Gjykatës. Asistenca për gjyqtarët ka të bëjë kryesisht me këshillime në çështjet e ngritura para Gjykatës, që kanë të bëjnë me raste të natyrave të ndryshme. Këshilltarët posaçërisht ndihmojnë në hartimin e korrespondencës, hartimin dhe përpilimin e raporteve, vendimeve dhe kujdesen po ashtu për procedurat tjera deri sa vendimet e Gjykatës të marrin formën përfundimtare.

Këshilltarët juridikë që punojnë në Gjykatë nuk janë shërbyes civilë, por kanë statusin e të punësuarit profesionist me kohë të pacaktuar në Gjykatë, me kushte të punës specifike dhe të përcaktuara me Rregullore të punës e me Udhëzimin praktik për Njësinë Ligjore. Sa i përket këshillimeve që ofrojnë ata janë të pavarur. Kompozicioni i tanishëm i këshilltarëve juridikë numëron 14 (katërbëdhjetë) këshilltarë, nga ta 11 (njëmbëdhjetë) janë senior dhe 3 (tre) të tjerë junior. Tre nga përbërja e tanishme e këshilltarëve juridikë janë ndërkombëtarë, të cilët vijnë nga vende të ndryshme, ndërsa pjesa dërmuese e tyre janë vendor dhe i përkasin etnive të ndryshme.

Njësia ligjore menaxhohet nga Këshilltari kryesor juridik dhe 2 (dy) zëvendëskëshilltarë. Këshilltari kryesor juridik vepron në kapacitet ndërlidhës ndërmjet Kryetarit të Gjykatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm, ai menaxhon dhe koordinon punën e Njesisë Ligjore përfshirë këshilltarët e lartë dhe këshilltarët e rinj, si dhe sekretarët ligjorë, që janë pjesë e Njesisë Ligjore.

Njësia ligjore mban takime të rregullta dy herë në javë për të diskutuar çështje të ndryshme kushtetuese, për të përcjellur gjendjen e rasteve, për të rishikuar mundësitë të akteve të brendshme të Gjykatës si dhe konsultime rreth praktikës gjyqësore.

Sa i përket ndjekjes së praktikës gjyqësore, Njësia Ligjore gjatë këtyre 6 (gjashtë) muajve të fundit të vitit 2014, ka formuar një databazë për gjitha rastet që nga themelimi i saj deri më sot duke përfshirë llojin e vendimit, natyrën e kontesteve, natyrën e shkeljeve të gjetura etj. Ky dokument menaxhohet nga një grup këshilltarësh dhe është i çastshëm nga të gjithë këshilltarët.

Sa i përket përcjelljes së gjendjes së rasteve Njësia Ligjore gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit mban një raport të rasteve që e përshkruan rastin, nga momenti kur i caktohet Këshilltari deri në publikimin e tij.

Gjatë vitit 2014, Njësia ligjore ka realizuar punëtori të ndryshme, ndër to vlen të përmendet punëtorja, e mbajtur në nëntor të vitit 2014, përkitazi me detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarëve juridikë dhe raportin e tyre me gjyqtarët.

Për më tepër, në muajin dhjetor të vitit 2014 është mbajtur një punëtori së bashku me Departamentin e Përkrahjeve Profesionale me ndihmën e GIZ-it ku është diskutuar për mospërputhjet gjuhësore-juridike në dokumentet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Risi për vitin 2014 ka qenë fillimi i implementimit të projektit të trajnimit profesional/praktikës së këshilltarëve juridikë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës Zyra në Prishtinë, dhe ambasada e Zvicrës që konsiston në dërgimin e dy këshilltarëve juridikë çdo 5 (pesë) muaj në Gjykatën

Evropiane për Drejtat e Njeriut në Strasburg. Qëllimi i këtij projekti është avancimi profesional i këshilltarëve juridikë në fushën e drejtave të njeriut.

Aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese

IX. Aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese

I. Udhëtimet zyrtare

30 janar - 6 shkurt 2014

Gjyqtarja Snezhana Botusharova mori pjesë në seminarin “Zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut” në Strasburg, Francë.

19 shkurt 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, qëndroi për një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me ftesë të universitetit amerikan “SMU Dedman School of Law”, në Dallas, me rastin e mbajtjes së ligjëratës para studentëve dhe profesorëve të universitetit “SMU Dedman School of Law”, me temën: “*Roli dhe pozita e gjykatave kushtetuese në Evropën juglindore: Rasti i Kosovës*”.

27 shkurt - 2 mars 2014

Gjyqtarja Snezhana Botusharova mori pjesë në takimin e radhës të “*ELI-European Law Institute*” në Vjenë të Austrisë.

19 mars 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, me ftesë të Universitetit të Gracit, mori pjesë në Konferencën me temë: “*Kosova si anëtare e bashkësisë ndërkombëtare – Aderimi në organizatat ndërkombëtare*”. Në Konferencën e organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Gracit, Kryetari Hasani mbajti ligjëratë në temën: “*Efektet strukturore të anëtarësimit në Këshillin e Evropës në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës*”.

22 prill - 24 prill 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, me ftesë të Universitetit të Bolonjës, mbajti ligjëratë në Institutin e Shkencave Juridike të Universitetit të Bolonjës, në temën: “*Drejtësia kushtetuese dhe transicionet në Evropën Qendrore dhe Lindore*”.

Kryetari Hasani, gjithashtu, ishte ftuar të marrë pjesë edhe në Kongresin ndërkombëtar e organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Bolonjës, në Ravena të Italisë, më 23 dhe më 24 prill 2014. Duke qenë njëri ndër folësit kryesor në këtë Kongres, Kryetari Hasani mbajti ligjëratë në temën: “*Gjykata Kushtetuese e Kosovës: Natyra e kompetencave në kuadër të së drejtës komparative*”.

4 qershor - 6 qershor 2014

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i prirë nga Kryetari Prof. dr. Enver Hasani, marrin pjesë në një vizitë zyrtare në kryeqytetin e Republikës së Sllovenisë, Lubjanë.

Gjatë qëndrimit në Lubjanë, Kryetari Hasani dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës takohen me homologët e tyre nga Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, në krye Kryetarin e kësaj Gjykate, z. Miroslav Mozetić.

Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës takohet edhe me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Sllovenisë, z. Branko Maslesha, si dhe Avokatin e Popullit të këtij vendi, znj. Vlasta Nussdorfer.

Qëllimi i kësaj ishte shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në gjyqësinë kushtetuese, si dhe thellimi i mëtejme i marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit ndërmjet gjykatave homologe të të dyja vendeve.

25 qershor - 29 qershor 2014

Z. Veton Dula, zyrtar për Marrëdhënie me Publikun mori pjesë në takimin e 13-të të Këshillit të Përbashkët të Drejtësisë Kushtetuese në Batumi të Gjeorgjisë.

7 - 9 tetor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit (GIZ)/Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, realizojnë një vizitë studimore të Gjykatës tonë në atë të Francës, më 7-10 tetor 2014, Paris, Francë.

Gjatë qëndrimit në kryeqytetin francez, Kryetari Hasani dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës takohen me Kryetarin e Këshillit Kushtetues të Francës, z. Jean-Louis Debré, si dhe me zëvendëskryetarin e Këshillit Shtetëror të këtij vendi, z. Jean-Marc Sauvé.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës zhvilloi takime edhe me zyrtarë të lartë në Ministrinë e Drejtësisë të Francës.

Qëllimi i kësaj vizite është shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në raportet ndërmjet gjykatave kushtetuese dhe gjykatave supreme të të dyja vendeve, në aspektin e mbrojtjes kushtetuese të të drejtave të njeriut.

Vizita është mundësuar me përkrahjen e Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

9 - 13 tetor 2014

I ftuar të marrë pjesë në Sesionin e 100-të Plenar të Komisionit të Venecias, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, udhëtoi për në Romë, më 9 tetor 2014.

Sesioni jubilar i Komisionit të Venecias këtë vit mbahet në kryeqytetin italian, më 10 dhe 11 tetor 2014, në të cilin Kryetari Hasani mori pjesë në cilësinë e anëtarit përfaqësues të Republikës së Kosovës.

Krahas pjesëmarrjes në këtë sesion, Kryetari Hasani gjithashtu është përzgjedhur anëtar i panelit në 6 (gjashtë) nënkomisione të Komisionit të Venecias: atë për të drejtat themelore, për të drejtën ndërkombëtare, për mbrojtjen e minoriteteve, për institucione demokratike, për marrëdhënie me jashtë dhe për gjyqësorin.

16 - 19 tetor 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani i ftuar nga Universiteti i Regensburg-ut, mori pjesë në Kongresin i XVI-të Ndërkombëtar për të Drejtën Evropiane dhe të Drejtën Kushtetuese Krahasimtare - Zhvillimet në të Drejtën Ndërkombëtare: E Drejta Civile dhe Kushtetuta, më 16 - 19 tetor 2014, në Regensburg, të Gjermanisë.

Në kuadër të pjesëmarrjes në këtë Kongres, Kryetari Hasani mbajti ligjëratë në temën: *“Roli i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës”*.

19 nëntor 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani i ftuar nga Fakulteti Juridik, Universiteti Hacettepe, mori pjesë në Kongresin “Edukimi Juridik”, më 19 nëntor 2014, në Ankara, Turqi.

Në kuadër të pjesëmarrjes në këtë Kongres, Kryetari Hasani mbajti ligjëratë në temën: *“Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e sundimit të ligjit në Kosovë: Edukimin për sundimin e ligjit”*.

26 - 28 nëntor 2014

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i prirë nga Kryetari Prof. dr. Enver Hasani, udhëtoi për një vizitë zyrtare në Mal të Zi.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u ftua për të marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me temë: *“Mbrojtja kushtetuese e të drejtave dhe lirive të njeriut”*, e cila u mbajt në Budvë, më 27 dhe 28 nëntor 2014, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi. Konferenca ndërkombëtare u organizua për shënimin e 50-vjetorit të gjyqësisë kushtetuese malazeze.

10 - 14 dhjetor 2014

Me ftesë për të marrë pjesë në Sesionin e 101-të Plenar të Komisionit të Venecias, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, dhe gjyqtarja Mr. sc. Arta Rama – Hajrizi, udhëtuan për në Venecia të Italisë.

Sesioni i 101-të Plenar i Komisionit të Venecias u mbajt më 12 dhe 13 dhjetor 2014, në të cilin Kryetari Hasani mori pjesë në cilësinë e anëtarit përfaqësues të Republikës së Kosovës, ndërkaq gjyqtarja Rama-Hajrizi si zëvendës-anëtare.

Kryetari Hasani morri pjesë si panelist edhe në punimet e dy nënkomisioneve të Komisionit të Venecias: për institucione demokratike dhe për të drejtat themelore.

II. Vizita zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

18 janar 2014

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, u mbajt ligjëratë nga Prof. dr. Mark Tushnet, profesori me renome ndërkombëtare i së Drejtës nga Universiteti i Harvardit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Profesori Tushnet ligjëroi në Gjykatën Kushtetuese, me temën: *“Gjykata të dobëta në këmbim të të drejtave të fuqishme: Pikëpamje mbi propozimin për regjimet transicionale të së drejtës, të bazuara në regjime të fuqishme të të drejtave kushtetuese të njeriut – rasti i Kosovës”*.

14 mars 2014

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e vizituan një grup studentësh nga Departamenti i Shkencave Politike të London School of Economics LSE. Qëllimi i kësaj vizite ishte diskutimi rreth kompetencave dhe sfidave ekzistuese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

12 maj 2014

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u shënua solemnisht fillimi i projektit me të cilin është bërë i mundur trajnimi i këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg.

Në këtë solemnitet, fjalë rasti pati Prof. dr. Enver Hasani, kryetar i Gjykatës Kushtetuese, znj. Krystyna Marty Lang, Ambasadore e Konfederatës së Zvicrës në Kosovë, si mbështetësi kryesor financiar i këtij projekti, si dhe z. Tim Cartwright, shef i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, që ndërmjetësoi realizimin e trajnimit në Strasburg.

Me fjalë përshëndetëse nga Strasburgu, pjesëmarrësve në këtë ceremoni ju drejtohen edhe dy këshilltarë ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët tashmë kanë filluar trajnimin e tyre në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

14 maj 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, priti në takim një delegacion nga Republika e Çekisë, i prirë nga Kryeprokurori i këtij vendi, z. Pavel Zeman. Në takim mori pjesë edhe ambasadori i Republikës së Çekisë në Kosovë, z. Jiri Dolezel.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në sistem gjyqësorë, si dhe thellimi i marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të të dyja vendeve.

29 maj 2014

Me rastin e 200 vjetorit të Kushtetutës Norvegjeze, Ambasada Mbretërore Norvegjeze në Prishtinë në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Prishtinës, ftoi të gjithë stafin e GJKK-së në seminarin vjetor "Kushtetutat dhe ndërtimi i Shtetit".

Kryetari Prof. dr. Enver Hasani mori pjesë në këtë seminar në cilësinë e folësit kryesor me temë: "Elementet kryesore të Kushtetutës së Kosovës dhe rëndësia për shtetndërtimin".

15 tetor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shënon Vitin e Pestë Gjyqësor, me një ceremoni solemne organizuar në sallën "Beethoven" të hotelit "Emerald" në Prishtinë, më 15 tetor 2014.

Në këtë solemnitet, morën pjesë delegacionet e nivelit më të lartë të Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, të Sllovenisë, të Luksemburgut, të Malit të Zi dhe të Shqipërisë.

Me një fjalim rasti, pjesëmarrësve në këtë ceremoni ju drejtua Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, Prof. dr. Dainius Zhalimas, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, Mr. Miroslav Mozetić, Profesori i mirënjohur nga Universiteti i Bolonjës, Prof. dr. Luca Mezzeti, si dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Prof. dr. Fejzullah Hasani.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, gjithashtu mirëpriti në një takim të përbashkët kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, Prof. dr. Dainius Zhalimas, gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese të Luksemburgut, z. Francis Delaporte, si dhe profesorin e shquar të së Drejtës kushtetuese nga Universiteti i Bolonjës, Prof. dr. Luca Mezzetti.

III. Seminare pune

11 - 13 janar 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, mbanë punëtorinë e dytë në Durrës, të Shqipërisë; përkitazi me hartimin juridik dhe përkthimet mbi:

- Takimi me parashtruesit, dorëzimi i kërkesës, dokumentet e nevojshme që duhet të dorëzojë parashtruesi, filtrimi i dokumenteve të nevojshme për t'u përkthyer;
- Letrat njoftuese, përgjigjet e palëve të treta dhe afatet kohore;
- Shabllonet për raporte paraprake dhe struktura e tyre;
- Palët e paautorizuara, mosshkrimi i mjeteve, e paafatshme;
- Qartazi e pabazuar, kriteret e tjera të pranueshmërisë;
- Terminologjia juridike dhe harmonizimi i saj në të tri gjuhët e punës;

22 janar 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Programin për Sundim Efektiv të Ligjit (EROL) të USAID-it, organizoi Konferencën Gjyqësore me temë: *“Natyra vetë-ekzekutive e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”*. Në këtë konferencë, ndër të tjera, trajtohet aftësia e gjykatave të rregullta për të referuar çështjet e ndryshme kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si dhe çështja e kompetencave dhe sfidave ekzistuese në marrëdhëniet reciproke. Moderator i konferencës ishte z. James B. Haines, gjyqtar federal nga distrikti Maine i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

28 - 29 janar 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Programin për Sundim Efektiv të Ligjit (EROL) të USAID-it, organizuan punëtorinë mbi Rregulloren e Punës të GJKK-së, në Prishtinë. Moderator i Punëtorisë ishte gjyqtari John Tunheim.

25 - 26 shkurt 2014

Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Supreme e Kosovës si një parakusht për Mbrojtjen Efektive të të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Themelore të garantuara me Kushtetutë, realizuan një seminar pune me titull: *“E drejta për gjykim të drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe problemet në implementimin e jurisprudencës së Strasburgut përkitazi me këtë çështje”*.

Ky seminar u realizua në Stamboll, të Turqisë; me mbështetje financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë dhe Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtare GIZ.

Moderatorë kryesor të këtij seminari ishin Prof. James Sweeney, Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin Lancaster në Mbretërinë e Bashkuar dhe Prof. Dr. Bengt Beutler, Profesor në Universitetin e Bremenit, në Gjermani.

3 mars 2014

Dy këshilltarë ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës kanë udhëtuar për në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut me seli në Strasburg, për një trajnim profesional pesëmuajsh.

Trajnimi dhe qëndrimi i këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Strasburgut është bërë i mundur me ndërmjetësimin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, dhe me mbështetjen financiare të Ambasadës së Zvicrës në Kosovë.

Falë donacionit të Ambasadës zvicerane dhe ndërmjetësimit të Zyrës së Këshillit të Evropës, të gjithë këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese do të kenë mundësi të trajnohen në Gjykatën e Strasburgut, me qëllim përvetësimin sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës.

4 - 6 maj 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, mbajti punëtorinë e tretë në Durrës, të Shqipërisë; përkitazi me hartimin juridik dhe përkthimet mbi:

- Takimi me parashtruesit, dorëzimi i kërkesës, dokumentet e nevojshme që duhet të dorëzojë parashtruesi, filtrimi i dokumenteve të nevojshme për t'u përkthyer;
- Letrat njoftuese, përgjigjet e palëve të treta dhe afatet kohore;
- Shabllonet për raporte paraprake dhe struktura e tyre;
- Palët e paautorizuara, mosshterimi i mjeteve, e paafatshme;
- Qartazi e pabazuar, kriteret e tjera të pranueshmërisë;
- Terminologjia juridike dhe harmonizimi i saj në të tri gjuhët e punës;

13 qershor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe me Fondacionin Gjerman "Hanns Seidel", organizoi Konferencën Rajonale me temë: *"Veçoritë e gjykimit kushtetues dhe dallimi nga juridiksioni i gjykimit të zakonshëm"*.

Në këtë Konferencë, krahas gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, morën pjesë edhe homologët e tyre nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë dhe Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi.

31 tetor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë, si dhe me Agjencinë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ), organizoi punëtorinë në temën: *"E drejta për gjykim të drejtë brenda afatit të arsyeshëm"*, e cila u mbajt të premtën, më 31 tetor 2014, në Prishtinë.

Pjesëmarrësve në këtë punëtori, me një fjalim përshëndetës, iu drejtua Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, ambasadorja e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, znj. Angelika Viets, si dhe z. Volkmar Theobald, menaxher i Projektit të Agjencisë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar në Kosovë (GIZ).

Në këtë punëtori, ndër të tjera, u trajtua çështja e rolit dhe e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese në trajtimin e shkeljeve të mundshme të së drejtës në gjykim të drejtë, brenda afatit të arsyeshëm.

Moderator i punëtorisë ishte Prof. dr. Andreas L. Paulus, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

11 - 12 nëntor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës dhe me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), organizoi punëtorinë në temën: *“Ndikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në vendimet e Gjykatës Supreme, përfshirë vendimet e gjykatave më të ulëta dhe çështja e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese”*, më 11 dhe 12 nëntor 2014.

Kjo punëtori, organizohet në vazhden e takimeve të rregullta dhe të bashkëpunimit të mirë ndërinstitucional ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe ka për qëllim shkëmbimin e mëtejme të përvojave të gjyqtarëve të të dy gjykatave përkitazi me obligimet që dalin nga aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe implementimin e tyre.

Folës dhe moderatorë të punëtorisë, e cila u mbajt në Mavrovë të Maqedonisë, ishin Prof. dr. Ulrich Karpen, profesor i së Drejtës publike në Universitetin e Hamburgut, dhe Prof. dr. Matthias Hartwig, profesor i së Drejtës kushtetuese në Universitetin e Heidelbergut në Gjermani.

2 dhjetor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Kosovës, si dhe me përkrahjen e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, organizon punëtorinë në temën: *“Kufijtë e vlerësimit të kushtetutshmërisë në rastet individuale (neni 113.7 i Kushtetutës) dhe efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese”*, më 2 dhjetor 2014, në Prishtinë.

Ndër temat kryesore që u trajtuan në këtë punëtori, ishte edhe çështja e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës.

Moderator i punëtorisë ishte Prof. dr. James Sweeney, profesor i së Drejtës ndërkombëtare në Universitetin Lancaster në Angli.

12 dhjetor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me programin e USAID-it për sundim efektiv të ligjit “EROLL”, organizoi punëtorinë në temën: *“SHBA-Kosovë: Referentët dhe këshilltarët juridikë - rolet dhe përgjegjësitë në gjykatat e tyre”*, më 10 - 12 dhjetor 2014, në Prishtinë.

Në këtë punëtori, ndër të tjera, u diskutua për rolin dhe për përgjegjësitë që kanë këshilltarët juridikë në gjykata, si dhe për marrëdhëniet e tyre të punës me gjyqtarët.

Moderator i punëtorisë ishte gjyqtari David Carter, nga Gjykata e Qarkut në SHBA, Distrikti Qendror i Kalifornisë.

16 dhjetor 2014

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit (GIZ)/ Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, organizoi punëtorinë në temën: “Përkthimi i dokumenteve juridike në gjuhët e punës së Gjykatës”, më 16 dhjetor 2014, në Prishtinë. Moderator i punëtorisë ishte Dr. Robert Muharremi.

24 dhjetor 2014

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. dr. Enver Hasani, mbanë konferencën e fundvitit me gazetarë, përkritazi me punën e Gjykatës Kushtetuese gjatë vitit që lam pas.

Shtojca I

SHTOJCA I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2014
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

Pranimet	Shën.	2014			2013			2012		
		Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme
		BKK	THV		BKK	THV		BKK	THV	
		€	€	€	€	€	€	€	€	€
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	2	1,384,900			1,527,704			1,394,014		
Të hyrat vetanake										
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara	3									
Grantet e përcaktuara të donatorëve	4			84,600						
Fondi i huazimeve	5									
Pranimet e tjera	6									
Totali i pranimeve		1,384,900	-	84,600	1,527,704	-	-	1,394,014	-	-

Pagesat										
Operacionet										
Pagat dhe mëditjet	7	837,307			737,776			707,409		
Mallrat dhe shërbimet	8	510,751		84,600	592,559			595,499		
Shërbimet komunale	9	7,074			9,365			9,701		
		1,355,132		84,600	1,339,700	-	-	1,312,610		-
Transferet										
Transferet dhe subvencionet	10									
Shpenzimet kapitale										
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	11	29,767			86,962			81,404		
Pagesat e tjera	12									
Pagesat gjithsej		1,384,900	-	84,600	1,527,704		-	1,394,014		-

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

		2014				2013	2012
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
	Shënime	€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Grantet dhe ndihma	16		89,890	84,600	5,290		
Pranimet kapitale	17						
Fondi i privatizimit	18						
Huazimet	19						
Të tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për BKK		-	89,890	84,600	5,290	-	-

Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	859,439	859,439	837,307	(22,132)	737,776	707,409
Mallrat dhe shërbimet	22	582,302	510,797	510,751	(46)	592,559	595,499
Shërbimet komunale	23	11,000	8,500	7,074	(1,427)	9,365	9,701
Transferet dhe subvencionet	24					101,042	
Shpenzimet kapitale	25	100,000	38,175	29,767	(8,408)	86,962	81,404
Fondi i privatizimit	26						
Të tjera	27						
Totali i pagesave të bërë nga BKK		1,552,741	1,416,911	1,384,900	(32,011)	1,527,704	1,394,014

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2014

Klasifikimi ekonomik	2014			2013	2012
	BKK	THV	Totali		
	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	837,307		837,307	737,776	707,409
Mallrat dhe shërbimet	510,751		510,751	592,559	595,499
Shërbimet komunale	7,074		7,074	9,365	9,701
Subvencionet dhe transferet				101,042	
Shpenzimet kapitale	29,767		29,767	86,962	81,404
	1,384,900	-	1,384,900	1,527,704	1,394,014

